



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.646, datë 23.12.2020

**PËR
CAKTIMIN E SEANCËS DËGJIMORE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR FILLIMIN E PROCEDIMIT
DISIPLINOR NË NGARKIM TË MAGJISTRATES {...}, ME DETYRË GJYQTARE NË
GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR KRUIJË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a pika 1, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 63 të ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, në nenin 138, pika 2 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në nenin 31, pika 1 dhe 2 të Rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori i saj, z. Medi Bici;

V E N D O S I:

1. Caktimin e datës 08.01.2021, ora 11:00, si datë e zhvillimit të seancës dëgjimore, për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë.
2. Ky vendim i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistrates {...}, brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR